SMART Technologies ULC
Marrëveshje me Përdoruesin për Licencën e Softuerit për Softuerin SMART Notebook 10 dhe softuerë të lidhur të SMART

Rishikimi i fundit: 8 dhjetor 2010

Ju lutemi lexojeni me kujdes këtë marrëveshje me përdoruesin për licencën e softuerit ("Licenca") përpara përdorimit të Softuerit. Duke përdorur Softuerin, ju bini dakord që të zbatoni kushtet dhe konditat e kësaj Licence. Nëse nuk bini dakord me kushtet e kësaj Licence, mos e përdorni Softuerin.

1. PËRKUFIZIMET:

1.1 **"Kompjuter"** nënkupton një kompjuter personal (qoftë në formë laptopi ose kompjuteri tavoline) pavarësisht se me cilin sistem operativ funksionon. Një Kompjuter mund të jetë i aftësuar për prekje ose për penë, me kusht që Kompjuteri të përdoret për përdorim vetjak sesa për shfaqje përpara shumë personave, dhe me kusht gjithashtu që ky Kompjuter të mos jetë i lidhur (përfshirë edhe lidhje pa tela) me një Produkt të Kufizuar. Një Kompjuter i lidhur me një Produkt të Kufizuar do të përbëjë dhe do të konsiderohet si një Produkt i Kufizuar.

1.2 **"Dokumentacion"** nënkupton manualet dhe udhëzuesit e patentuar të SMART Technologies ULC (SMART) për këtë Softuer, qofshin në formë të printuar apo elektronike

1.3 **"Përdorues" (**ose në formë alternative referuar si "ju") nënkupton Organizatën e pajisur me Licencë dhe, aty ku aplikohet, çdo punonjës (duke përfshirë, por pa u kufizuar me, mësuesit dhe instruktorët), konsulentët, studentët dhe persona të tjerë të interesuar brenda Vendndodhjes të cilët përdorin Softuerin.

1.4 **"Produkt i Licencuar"** nënkupton çdo produkt të aplikueshëm SMART që përfshin në çmimin e tij, ose që dërgohet së bashku me, aplikacionin e aplikueshëm të Softuerit, por që në rastin e Produkteve të Licencuara të softuerit SMART Notebook kufizohen me: (a) tabelën e bardhë interaktive SMART Board™, (b) sistemin interaktiv të përgjigjeve SMART Response™, (c) ekranin interaktiv të penës SMART Podium™, (d) SMART Document Camera, dhe/ose (e) ekranin interaktiv SMART, sipas rastit, dhe (f) çdo produkt tjetër SMART që nxjerr SMART-i herë pas here dhe që identifikohet si Produkt i Licencuar.

1.5 **"Organizata e Licencuar"** nënkupton personin juridik ose fizik (ose individin nëse është siguruar në mënyrë vetjake) i cili ka siguruar Produktin e Licencuar dhe këtë Licencë shoqëruese për llogari të tij dhe, ku aplikohet, për llogari të Përdoruesve të tij.

1.6 **"Produkt i Licencuar"** nënkupton (a) çdo tabelë të bardhë interaktive të aftësuar për prekje ose penë, pajisje me ekran me prekje, pllaka, ekran për shfaqje ose projektues, që nuk është Produkt i Licencuar, dhe (b) në rastin e Softuerit SMART Notebook Varianti për Studentë, produkte të tilla që referohen në nënpikën (a) më lart, nëse përdoren në dobi të më shumë se një personi njëkohësisht, dhe (c) çdo produkt i furnizuar nga SMART-i që nuk është Produkt i Licencuar. Si përjashtim, pajisjet me prekje ose penë, pa ekran (siç janë pllakat, përveç pllakës interaktive SMART Slate) mund të përdoren me Softuerin vetëm kur lidhen (përfshirë edhe lidhje pa tela) me një Produkt të Licencuar, dhe ky kombinim do të konsiderohet përdorim i lejuar i Softuerit. Si përjashtim i mëtejshëm, Softueri mund të përdoret me SMART Slate edhe nëse SMART është e lidhur apo jo me një Produkt të Licencuar, me kusht që të paktën një Produkt i Licencuar të jetë blerë për Vendndodhjen.

1.7 **"Vendndodhje"** nënkupton një Organizatë të vetme të Licencuar dhe çdo Kompjuter nën kujdesin dhe kontrollin e Organizatës së Licencuar dhe studentëve, punonjësve, konsulentëve ose anëtarëve të interesuar të Organizatës së Licencuar (për sa kohë që vazhdojnë të jenë studentë, punonjës, konsulentë ose anëtarë të interesuar të Organizatës së Licencuar) i përdorur për qëllimin parësor të aktiviteteve që lidhen me Organizatën e Licencuar; për qartësim, punonjësit, studentët dhe konsulentët e Organizatës së Licencuar, përfshijnë punonjësit, studentët dhe konsulentët e distriktit të

bordit të shkollës që mbikëqyrin Organizatën e Licencuar ose shkollat individuale brenda Organizatës së Licencuar, siç aplikohet.

1.8 **"Sistem interaktiv përgjigjeje SMART Response"** nënkupton si softuerin SMART Response ashtu edhe pajisjet vartëse të përdorura nga studentët (për shembull, telekomandat ose klikuesit portativë SMART Response ose softuerë të përdorur nga Kompjuterët e Studentëve për të dhënë përgjigje).

1.9 **"Softuer"** nënkupton secilin dhe kolektivisht të gjitha softuerët dhe firmuerët e mëposhtëm të patentuar SMART, siç aplikohet: Softueri SMART Notebook, softueri i SMART Notebook™ varianti për studentë, softueri SMART Response, softueri SMART Notebook Math Tools, secili i përbërë nga programi(et) kompjuterik(e) në formë kodi objekti (duke përfshirë secilën dhe të gjitha përditësimet, nxjerrjet në shitje, bazat e të dhënave dhe përmirësimet) që i furnizohet Përdoruesit dhe çdo kopje në përputhje me këtë Licencë. Softueri do të përfshijë gjithashtu çdo softuer të palëve të treta dhe dokumentacionin që i dërgohet përdoruesit nga SMART-i. Softueri mund të përfshihet brenda ose të jetë i instaluar në Produktet e Licencuara, të shkarkuara nga faqja e internetit e SMART -it ose CD-ja e dhënë nga SMART-i, ose të instaluar në USB-në e dhënë nga SMART-i.

1.10 **"Kompjuterët e Studentëve"** nënkupton numrin e përcaktuar të Kompjuterëve të studentëve që janë licencuar brenda Vendndodhjes (pra, numri i licencave të përdorura nga studentët që janë blerë nga Organizata e Licencuar).

1.11 **"Përdor" ose "Përdorim"** nënkupton instalimin, ngarkimin, ekzekutimin, hyrjen, vënien në punë, shfrytëzimin, ruajtjen apo paraqitjen e Softuerit, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

2. DHËNIA E LICENCËS:

2.1 **E përgjithshme.** Kjo Licencë është një marrëveshje ligjore mes Përdoruesit (qoftë individ ose Organizatë e Licencuar) dhe SMART Technologies ULC për Përdorimin e Softuerit. Në rast se sistemet ose administratori teknik i organizatës së licencuar, ose një përfaqësues tjetër, I pranon këto kushte për llogari të të gjithë Përdoruesve të menduar të organizatës së licencuar, është përgjegjësia e kësaj organizate të licencuar të sigurojë që kushtet e kësaj Licence të kuptohen dhe të zbatohen nga secili Përdorues. Softueri mbrohet nga ligjet për të drejtat e autorit, traktatet ndërkombëtare për të drejtat e autorit si dhe ligjet e marrëveshjet e tjera që mbrojnë pronën intelektuale. Të drejtat në këtë Licencë u rezervohen vetëm të drejtave të autorit të SMART dhe licencuesve të SMART për Softuerin dhe nuk përfshijnë të drejta të tjera për patenta apo të drejta të pronës intelektuale. Softueri licencohet, nuk shitet dhe u nënshtrohet kushteve dhe kufizimeve të kësaj Licence. Në rast se Softueri jepet nga SMART-i në CD, DVD, USB ose ndonjë formë tjetër fizike për transportimin e të dhënave, Organizata e Licencuar, ose (ku aplikohet) Përdoruesi, zotëron mjetin në të cilin është regjistruar Softueri, por SMART-i dhe/ose licencuesi(t) e SMART-it ruajnë të drejtën e pronësisë për vetë Softuerin. Kushtet e kësaj Licence do të vlejnë për çdo ndryshim të ri të softuerit që sigurohet nga SMART-i i cili zëvendëson dhe/ose plotëson Softuerin origjinal, përveç rastit kur ky ndryshim shoqërohet nga një licencë e veçantë, rast në të cilin do të vlejnë kushtet e asaj licence.

2.2 **Dhënia e Licencës.** Për çdo aplikacion Softuer të licencuar dhe paguar nga Organizata e Licencuar, SMART-i jep dhe Përdoruesi pranon një licencë jo ekskluzive, të patransferueshme dhe jo të nën-licencueshme, për të përdorur Softuerin me Produktin SMART, e cila u nënshtrohet kufizimeve të mëposhtme:

(a) Për **Softuerin SMART Notebook**:
Përdoruesi mund ta përdorë Softuerin:

i) në Produktin e Licencuar dhe/ose Kompjuterin e lidhur (përfshirë edhe lidhje pa tela) me një Produkt të Licencuar,

ii) në çdo Kompjuter të zotëruar dhe kontrolluar nga Organizata e Licencuar gjithmonë me kusht që Kompjuteri të mos jetë i lidhur (duke përfshirë edhe lidhjen pa tela) me një Produkt të Kufizuar; dhe

iii) nëse Organizata e Licencuar ka punonjës ose konsulentë, në një numër të arsyeshëm Kompjuterësh që mund të zotërohen personalisht nga punonjësit e Organizatës së Licencuar, konsulentët, studentët ose anëtarët e interesuar, me kusht që Softueri të përdoret për qëllimin parësor të aktiviteteve të lidhura me Organizatën e Licencuar dhe të kufizohet për kohëzgjatjen që këta individë vazhdojnë të veprojnë për llogari të, ose të jenë studentë të, Organizatës së Licencuar, dhe me kusht gjithashtu që Kompjuteri të mos jetë i lidhur (përfshirë edhe lidhjen pa tela) me një Produkt të Kufizuar.

(b) Për **Për Softuerin SMART Notebook Varianti për Studentë**:
Bazuar në numrin e përcaktuar të kompjuterëve të licencuar për studentët:

i) në një pajisje personale kompjuterike gjithmonë me kusht që kjo pajisje të mos jetë pajisja parësore e lidhur (përfshirë edhe lidhjen me tela) me një Produkt të Kufizuar; dhe

ii) në rast se softueri SMART Notebook Versioni për Studentë është i instaluar në një USB SMART, Përdoruesi mund ta përdorë Softuerin në çdo Kompjuter në Vendndodhje, gjithmonë me kusht që kompjuteri të mos jetë i lidhur (përfshirë edhe lidhjen pa tela) me një Produkt të Kufizuar.

(c) Për **Softuerin SMART Response**:
Me kusht që Organizata e Licencuar të zotërojë një sistem interaktiv përgjigjeje SMART Response (duke përfshirë pajisjet përkatëse portative), Përdoruesi mund ta përdorë Softuerin (i) në një numër të arsyeshëm kompjuterësh që zotërohen dhe kontrollohen prej Organizatës së Licencuar, gjithmonë me kusht që Përdoruesi të mos e instalojë Softuerin në një kompjuter të lidhur (përfshirë edhe lidhjen pa tela) me një Produkt të Kufizuar; dhe (ii) në një numër të arsyeshëm kompjuterësh që mund të zotërohen personalisht nga punonjësit, konsulentët, studentët ose anëtarët e interesuar të Organizatës së Licencuar dhe kufizohet për sa kohë që ata vazhdojnë të veprojnë për llogari të organizatës së licencuar, dhe me kusht gjithashtu që Kompjuteri të mos jetë i lidhur (përfshirë edhe lidhjen pa tela) me një Produkt të Kufizuar.

(d) Për **Sistemin interaktiv të përgjigjes SMART Response CE**:
Organizatës së Licencuar i jepet gjithashtu numri i licencave të SMART Notebook Varianti për Studentë për Kompjuterët për Studentë të blera nga Organizata e Licencuar që është subjekt i këtyre kushteve të përgjithshme (në paragrafin 2.2 (b) më lart). Përdoruesi mund ta transferojë SMART Notebook Varianti për Studentë nga një Kompjuter në një Kompjuter tjetër me kusht që përpara aktivizimit në një Kompjuter tjetër, të hiqet nga Kompjuteri origjinal nga i cili po transferohet.

(e) Për **Sistemin interaktiv të përgjigjes SMART Response VE**:
Përveç kushteve të kësaj Licence për Softuerin SMART Response, përdorimi i modalitetit SMART Response VE i softuerit do të jetë subjekt i kushteve të mëtejshme të përdorimit, të përcaktuara në faqen në linjë të kushteve të aplikueshme të përdorimit të SMART-it.

(f) Për **Softuerin SMART Notebook Math Tools**:
Bazuar në numrin e specifikuar të Kompjuterëve të licencuar, secila licencë e lejon Përdoruesin të përdorë Softuerin në një Kompjuter të vetëm ose pajisje tjetër të zotëruar dhe kontrolluar nga Përdoruesi. Përdoruesi duhet të ketë një licencë të vlefshme të softuerit SMART Notebook në atë Kompjuter, përdorimi i të cilit do të jetë subjekt i të gjitha kushteve të licencës të përcaktuara në paragrafin 2.2 (a) më lart. Përdoruesi duhet të pranojë kushtet e kësaj Licence për çdo instalim të Softuerit në një Kompjuter të veçantë ose pajisje tjetër.

(g) **Versionet provë**. Në lidhje me dhëniet paraprirëse të licencës: Përdoruesi mund të përdorë një kopje të versionit provë të softuerit të aplikueshëm vetëm (i) për periudhën e kohës të specifikuar në kopjen e këtij Softueri, ose në uebsajtin e shkarkimit të Softuerit, dhe nëse nuk ka të specifikuar një datë të tillë, data më e hershme prej: tridhjetë (30) ditë nga data e pranimit nga ana e Përdoruesit të kësaj Licence ose përdorimit nga ana e Përdoruesit i Softuerit; dhe (ii) në përputhje me dhëniet e mësipërme të licencës në paragrafin 2.2 (a) deri (d) gjatë kësaj periudhe prove, duke përfshirë kufizimet në lidhje me Përdorimin vetëm në Produkte të Licencuara. Një

version provë i Softuerit nuk jepet për Produktet e Kufizuara dhe Përdoruesit nuk i jepet e drejta të përdorë versionin provë të softuerit në ndonjë Produkt të Kufizuar. DUKE PËRDORUR VERSIONIN PROVË TË SOFTUERIT PËRDORUESI PRANON DHE BIE DAKORD SE PAS PERIUDHËS SË PËRAFËRT TË KOHËS TË SPECIFIKUAR NË SOFTUER OSE NË MATERIALET SHOQËRUESE TË SOFTUERIT, LICENCA E PROVËS DO TË PËRFUNDOJË DHE SOFTUERI MUND T'I HEQË TË DREJTËN PËRDORUESIT TË VAZHDOJË TË KETË AKSES DHE/OSE TA PËRDORË KËTË SOFTUER PROVË OSE ÇDO TË DHËNË APO PËRMBAJTJE QË PËRDORUESI MUND TË KETË HEDHUR NË KËTË SOFTUER NË RAST SE PËRDORUESI NUK BLEN NJË LICENCË PËR VERSIONIN E PLOTË PËRKATËS TË KËTIJ SOFTUERI. Të gjitha kushtet e kësaj Licence i aplikohen përdorimit provë të softuerit, duke përfshirë, pa u kufizuar me, kufizimet e përcaktuara në paragrafin 2.3 më poshtë. Në fund të periudhës së provës, do të ndërpritet përdorimi i Softuerit nga Përdoruesi. Nëse përdoruesi zgjedh të kalojë nga versioni provë i Softuerit në versionin e plotë të licencuar të Softuerit duke aplikuar procesin e zhbllokimit nëpërmjet blerjes së licencës brenda Softuerit (nëse aplikohet) ose nëpërmjet një procesi tjetër për blerje licence, përdorimi nga ana e Përdoruesit të versionit të ri të zhbllokuar të Softuerit duhet të jetë në përputhje me kushtet përkatëse të përgjithshme të kësaj Licence.

2.3 Kushte të tjera të Licencës. Dhënia e licencës në paragrafin 2.2 i nënshtrohet kushteve të mëposhtme shtesë të licencës:

(a) **Kopjet**. Përdoruesi mund të bëjë një kopje të Softuerit në format të lexueshëm nga makina vetëm si rezervë, me kusht që kjo rezervë të përfshijë të gjitha njoftimet për markat, të drejtat e autorit dhe njoftime të tjera pronësie që gjenden në mjetin origjinal. Përdoruesi mund ta kopjojë dokumentacioni vetëm për qëllime të brendshme. Përdoruesi nuk mund të shpërndajë kopje të Softuerit apo të çfarëdo pjese përbërëse të Softuerit;

(b) **Ruajtja e të drejtave**. SMART-i rezervon të gjitha të drejtat që nuk jepen shprehimisht;

(c) **Përdorimi në Produktet e Kufizuara**. Individët mund të përdorin SMART Notebook Express (subjekt i Kushteve të Përdorimit në atë sajt) që gjendet në: express.smarttech.com me çdo pajisje, duke përfshirë edhe Produktet e Kufizuara. Në rast se Përdoruesi dëshiron të përdorë softuerin SMART Notebook, SMART Response, ose SMART Notebook Varianti për Studentë me një Produkt të Kufizuar, Përdoruesi duhet të marrë leje paraprake nga SMART-i për ta përdorur këtë Softuer në një Produkt të Kufizuar (kjo leje këtu e tutje do të referohet si "Licenca e Softuerit të Pavarur Notebook"). SMART ruan të drejtën ta refuzojë këtë leje. Për qartësim, përdoruesit e Notebook Varianti për Studentë, të cilët janë studentë, mund ta përdorin Softuerin Notebook Varianti për Studentë në Kompjuterë që janë PC me tabelë me prekje (me kusht që ky përdorim të kufizohet vetëm në dobinë personale të këtij individi).

(d) **Licenca e Softuerit të Pavarur Notebook** . Në rast se kjo licencë softueri të pavarur Notebook lejohet nga SMART-i, Përdoruesi duhet t'i sigurojë SMART-it numrin e serisë së Produktit(eve) të Kufizuar(a) për ta mundësuar SMART-in që të krijojë një çelës licence që do të përdoret nga Përdoruesi për të aktivizuar Licencën e Softuerit të Pavarur. Në këtë mënyrë, Licenca e Softuerit të Pavarur Notebook është e patransferueshme dhe Softueri nuk mund të Përdoret me Produkt(e) të Kufizuar(a) të ndryshëm nga Produkti i Kufizuar për të cilin numri i serisë i është siguruar SMART-it nga Përdoruesi për atë Licencë Softueri të Pavarur Notebook. Përdoruesi, përveç Produktit të Kufizuar të regjistruar pranë SMART-it, mund ta përdorë Licencën e Softuerit të Pavarur Notebook në (i) një kompjuter të zotëruar dhe kontrolluar nga Organizata e Licencuar; dhe (ii) nëse Organizata e Licencuar ka punonjës ose konsulentë, në një kompjuter që mund të zotërohet personalisht nga punonjës ose konsulentë të Organizatës së Licencuar, për sa kohë që vazhdojnë të jenë punonjës ose konsulentë të Organizatës së Licencuar, dhe me kusht që të përdoret për qëllimin parësor të aktiviteteve të lidhura me Organizatën e Licencuar.

(e) **Modifikimet dhe përmirësimet nga ana e Përdoruesit**. Përdoruesi nuk mund të modifikojë, përmirësojë apo të ndryshojë Softuerin, dhe as të krijojë punë derivate bazuar në Softuer, ose të shkrijë apo të ndajë Softuerin apo çdo përbërës të tij pa miratimin paraprak me shkrim nga SMART-i;

(f) **Ndalimi i zbërthimit për qëllim duplikimi.** . Përdoruesi nuk mund zbërthejë për qëllim duplikimi, të ristrukturojë, të përkthejë gjuhën e programit, të zbërthejë kodin e burimit në kod të lexueshëm, të modifikojë, të krijojë punë derivate ose të përpiqet të nxjerrë kodin e burimit (ose idetë në të, algoritmet, strukturën apo organizimin) nga Softueri apo nga çdo përbërës të tij, për çfarëdo qëllimi, duke përfshirë edhe qëllimin e zbulimit të çfarëdo aspekti të teknologjisë së tij. Përdoruesi mund t'i kryejë këto aktivitete me kusht që këto aktivitet të kufizohen deri në masën minimale që kërkohet për të funksionuar me programet e tjera kompjuterike të zhvilluara në mënyrë të pavarur dhe vetëm deri në masën minimale që ky aktivitet lejohet shprehimisht dhe rreptësisht nga ligji në fuqi, pavarësisht kufizimit të lartpërmendur;

(g) **Transferimi**. Përveçse kur lejohet shprehimisht në këtë Licencë, Përdoruesi nuk mund t'i japë një pale të tretë me qira, t'i huazojë apo t'i nënlicencojë, t'i shpërndajë apo t'i furnizojë asaj Softuerin apo përbërës të tij.. Ky kufizim përfshin çelësin e licencës së produktit që merr Përdoruesi ose i është dhënë Përdoruesit nga SMART-i për instalimin apo aktivizimin e Softuerit. Ky kufizim i aplikohet gjithashtu edhe postimit të çfarëdo pjese të Softuerit në uebsajtet publike;

(h) **Ligjet në fuqi**. Përdoruesi duhet të pajtohet me të gjitha ligjet në fuqi në lidhje me përdorimin e Softuerit dhe të çdo përbërësi të tij;

(i) **Njoftimet e pronësisë**. Përdoruesi duhet të ruajë të gjitha njoftimet për markat, të drejtat e autorit dhe njoftime të tjera pronësie në të gjitha kopjet e Softuerit;

(j) **Aksesi në programet e palëve të treta**. Softueri mund të përfshijë dhe/ose të shoqërohet nga përmbajtje dhe programe softuerë të palëve të treta (kolektivisht, "Pjesët përbërëse të palëve të treta") që mund të kërkojnë një marrëveshje të veçantë për licencë nga pala e tretë, disa prej të cilave mund t'ju sigurohen për rishikim në instalimin e parë ose përditësimet e mëvonshme të Softuerit. Asnjë nga të drejtat e përshkuara në këtë licencë nuk i aplikohet këtyre pjesëve përbërëse të palëve të treta. Disa nga softuerët falas (friuerë) ose pjesët përbërëse open source të palëve të treta vihen në dispozicion sipas kushteve të licencave të tyre përkatëse (të cilat ndodhen në dritaren About, te Prona Intelektuale) kushtet e të cilave mund të jenë të ndryshme ose plotësuese nga ato që përmban kjo Licencë. Pranimi i kësaj licence konfirmon gjithashtu edhe pranimin e kushteve të licencës së këtij softueri falas (friuer) ose open source. SMART-i nuk vërteton apo promovon produktet apo shërbimet e ofruara nga palë të treta që ofrojnë pjesët përbërëse të palëve të treta. Softueri gjithashtu mund të përmbajë dhe/ose të shoqërohet nga mjetet dhe instrumentet zhvilluese të SMART-it, të cilat mund t'u nënshtrohen marrëveshjeve të veçanta të licencave. Ju pranoni se është përgjegjësia juaj të lexoni, pranoni dhe zbatoni kushtet e përgjithshme të këtyre pjesëve përbërëse të palëve të treta dhe marrëveshjeve të licencave të mjeteve e instrumenteve zhvilluese të SMART-it;

(k) **Lidhjet me uebsajtet e palëve të treta**. Lidhjet me uebsajtet e palëve të treta jepen vetëm për 'qëllime informimi' dhe SMART-i nuk është përgjegjës për përmbajtjen e palëve të treta që ndodhet në këto faqe duke përfshirë, por pa u kufizuar me, informacionin në lidhje me produkte apo shërbime; dhe

(l) **E drejta e autorit për përmbajtjen**. Të gjitha të drejtat e pronësisë së titujve dhe intelektuale mbi dhe për përmbajtjen dhe që mund të inkorporohen nëpërmjet përdorimit të Softuerëve ose produkteve të SMART-it janë pronë e zotëruesit përkatës të përmbajtjes dhe janë të mbrojtura nga ligjet dhe traktatet e aplikueshme për të drejtat e autorit apo të pronës intelektuale. Kjo Licencë nuk ju jep të drejta për ta përdorur këtë përmbajtje.

2.4 Përdorimi si duhet i softuerit. Përdoruesi pranon që ruajtja e integritetit të Softuerit dhe plotësimi nga ana e SMART-it të detyrimeve të përshkruara në këtë Licencë mbështeten në përdorimin si duhet dhe mirëmbajtjen e Softuerit nga Përdoruesi. Përdorim dhe mirëmbajtje si duhet do të thotë që Përdoruesi:

(a) do të instalojë të gjitha ndryshimet dhe versionet e reja të vëna në dispozicion nga SMART-i;

(b) do ta përdorë Softuerin në përputhje me dokumentacionin e siguruar nga SMART-i dhe me kushtet e konditat e kësaj Licence; dhe

(c) do të ndjekë udhëzimet e SMART-it për instalimin e versioneve të reja dhe për korrigjimin dhe shmangien e defekteve në program (bug) dhe riparimeve në Softuer.

3. DORËZIMI DHE INSTALIMI:

3.1 Softueri mund të shkarkohet nga uebsajti i SMART-it ose CD-ja, ose të instalohet në USB-ja e SMART-it. Përveç rastit kur Softueri dërgohet së bashku me një Produkt të Licencuar, Softueri do të dërgohet me transport falas (F.C.A. - Incoterms 2000) nga pika e prodhimit SMART. Përdoruesi pranon dhe bie dakord që ai do të jetë përgjegjësi kryesor për instalimin e Softuerit.

3.2 **Pranimi.** Përdoruesi bie dakord që Softueri do të konsiderohet i dorëzuar dhe i pranuar me marrjen e Softuerit dhe/ose Produktit të Licencuar (nëse aplikohet).

4. SHËRBIMET E NDIHMËS: Gjatë orarit normal të punës, mund të ofrohet ndihmë teknike pa pagesë shtesë nga SMART-i për çdo problem instalimi që shfaqet gjatë shpërndarjes fillestare të softuerit. Çdo ndihmë teknike që ka lidhje me softuerin pas shpërndarjes fillestare ("Shërbimet e ndihmës") do të jepen nga SMART-i sipas gjykimit të vet dhe mund të jenë subjekt pagese. Përdoruesi pranon se SMART-i ruan të drejtën për të ngarkojë tarifa shtesë dhe/ose të kufizojë Shërbimet e Ndihmës për Softuerin e siguruar sipas licencës së Softuerit të Pavarur Notebook. Shërbimet e Ndihmës, nëse ka, kufizohen me versionin aktual të Softuerit dhe me versionin e mëparshëm. Përdorimi i Shërbimeve të Ndihmës, nëse ka, drejtohen nga politikat dhe programet e SMART-it të përshkuara në Dokumentacionin dhe/ose materiale të tjera të SMART-it sipas ndryshimeve të herëpashershme nga SMART-i. Çdo softuer apo firmuer shtesë që i sigurohet Përdoruesit si pjesë e Shërbimeve të Ndihmës do të konsiderohet si pjesë e Softuerit dhe u nënshtrohet kushteve të kësaj Licence. Në çdo rast, Përdoruesi, dhe jo SMART-i, pranon përgjegjësinë për (i) përzgjedhjen e softuerit për të arritur rezultatet e dëshiruara; dhe (ii) instalimin, përdorimin dhe rezultatet e marra nga Softueri. Përdoruesi pranon se SMART-i nuk do të ofrojë Shërbimet e Ndihmës për versionet provë të Softuerit.

5. ZËVENDËSIMI, MODIFIKIMI DHE PËRMIRËSIMI I SOFTUERIT: SMART-i rezervon të drejtën në çdo kohë të zëvendësojë, modifikojë apo përmirësojë Softuerin, ose çdo përbërës të tij, duke i ofruar Përdoruesit një version zëvendësues apo të modifikuar të Softuerit, apo të çdo pjese përbërëse të tij apo përmirësimit, si dhe t'i kërkojë Përdoruesit të paguajë për çdo zëvendësim, modifikim apo përmirësim. Çdo zëvendësim apo Softuer i modifikuar apo përmirësim i Softuerit dhe i çdo pjese përbërëse të tij, që i ofrohet Përdoruesit nga SMART-i do të konsiderohet pjesë e Softuerit dhe do t'i nënshtrohet kushteve të kësaj Licence. Në rast se SMART-i ofron zëvendësimin, një version të modifikuar, ose të përmirësuar të Softuerit (a) vazhdimi i përdorimit të Softuerit nga Përdoruesi kushtëzohet nëse ai e pranon këtë version zëvendësues,të modifikuar, apo të përmirësuar të Softuerit dhe nga çdo marrëveshje zëvendësuese shoqëruese e Përdoruesit dhe (b) në rastin e zëvendësimit, modifikimit apo përmirësimit të Softuerit, ndërpritet përdorimi i versioneve të mëparshme të Softuerit nga ana e Përdoruesit.

6. ZGJIDHJA: Kjo licencë mbetet në fuqi deri sa të zgjidhet. Përdoruesi mund ta zgjidhë këtë Licencë në çdo kohë duke mos e përdorur softuerin dhe duke shkatërruar të gjitha kopjet e softuerit në zotërim të Përdoruesit. Përfundimi i periudhës së provës do të jetë edhe zgjidhja automatike e licencës dhe në fund të kësaj periudhe prove Përdoruesi duhet të mos e përdorë Softuerin dhe duhet të shkatërrojë të gjitha kopjet e Softuerit në zotërim të Përdoruesit. Pa paragjykuar të drejta të tjera, SMART-i mund ta zgjidhë këtë Licencë nëse, sipas gjykimit të SMART, Përdoruesi nuk arrin të zbatojë kushtet e përgjithshme të kësaj Licence. Në rast të tillë, Përdoruesi duhet të ndërpresë menjëherë përdorimin e Softuerit, të shkatërrojë të gjitha kopjet e Softuerit dhe të gjitha pjesët e tij përbërëse, të kthejë ose shkatërrojë të gjithë dokumentacionin që zotëron dhe sipas kërkesës, të sigurojë një dëshmi nën betim e cila vërteton zbatimin e veprimeve të mësipërme nga ana e Përdoruesit.

7. KUFIZIMET E EKSPORTIT: KUFIZIMET E EKSPORTIT: Përdoruesi bie dakord që nuk do t'ia eksportojë apo rieksportojë Softuerin ose cilëndo pjesë përbërëse të tij, ose cilindo proces ose shërbim që është

produkt i drejtpërdrejtë i Softuerit (bashkërisht referuar si “Përbërësit e Kufizuar”) asnjë shteti, personi apo subjekti që u nënshtrohet kufizimeve eksportuese kanadeze apo amerikane. Përdoruesi bie dakord në veçanti të mos eksportojë apo rieksportojë asnjë nga Përbërësit e Kufizuar (i) në asnjë shtet ku Kanadaja apo SHBA kanë vendosur embargo apo kanë kufizuar eksportin e mallrave apo shërbimeve ose shtetasve të këtyre vendeve, kudo qofshin (ii) asnjë personi apo subjekti të cilin Përdoruesi e di apo ka arsye të dijë se do t’i përdorë Përbërësit e Kufizuar në projektimin, zhvillimin, prodhimin apo vënien në funksionim të armëve bërthamore, kimike apo biologjike, ose përdorimin ose trajnimin për raketa që lidhen me to ose (iii) asnjë personi ose subjekti të cilit i është ndaluar pjesëmarrja në transaksionet kanadeze apo amerikane të eksportit nga një organ zyrtar i qeverisë kanadeze apo amerikane. Përdoruesi garanton dhe siguron që asnjë zyrtar i qeverisë kanadeze apo amerikane nuk ka pezulluar, anuluar apo mohuar privilegjet eksportuese të Përdoruesit.

8. **TË DREJTAT PËR KUFIZIM TË QEVERISË AMERIKANE:** Softueri është “Artikull i Tregtueshëm", sipas përkufizimit të këtij termi nga 48 CFR 2.101, dhe përbëhet nga “Softueri Kompjuteri i Tregtueshëm” dhe “Dokumentacioni i Softuerit Kompjuterik të Tregtueshëm”, në kuptimin e përdorur për këto terma në 48 CFR 12.212 ose 48 CFR 227.7202, siç aplikohet. Sipas 48 CFR 12.212 ose 48 CFR 227.7202-4, siç aplikohet, Softueri Kompjuterik i Tregtueshëm dhe Dokumentacioni i Softuerit Kompjuterik të Tregtueshëm u licencohen Përdoruesve të Qeverisë së ShBA-së (a) vetëm si Artikuj të Tregtueshëm; dhe (b) vetëm me ato të drejta që u jepen të gjithë Përdoruesve të tjerë në përputhje me kushtet e përgjithshme të kësaj Licence.

9. **MUNGESA E GARANCISË:** Nëse Softueri del me defekt, SMART-i mund ta zëvendësojë softuerin deri në nëntëdhjetë (90) ditë nga data e blerjes së licencës; në rast të kundërt, Përdoruesi merr përsipër të gjithë kostot e nevojshme për shërbimin, riparimin apo korrigjimin e Softuerit. SMART-i nuk garanton se Softueri, ose çdo pjesë e tij, funksionon me Produkte të Kufizuara në të njëjtën mënyrë që funksionon me Produktin e Licencuar. ÇDO PËRDORIM I SOFTUERIT SIGUROHET “SIÇ ËSHTË” DHE PËRDORUESI E PËRDOR ATË DUKE E MARRË VETË PËRSIPËR RREZIKUN. DERI NË MAKSIMUMIN QË LEJOHET NGA LIGJI NË FUQI, SMART DHE FURNITORËT E TIJ HEQIN DORË NGA GARANCIA DHE KUSHTET, QOFSHIN TË SHPREHURA OSE TË NËNKUPTUARA, DUKE PËRFSHIRË, POR PA U KUFIZUAR ME, GARANCITË E NËNKUPTUARA TË TREGTUESHMËRISË, PËRSHTATSHMËRISË PËR NJË QËLLIM TË CAKTUAR, TITULLIN DHE MOSSHKELJEN NË LIDHJE ME PRODUKTIN E LICENCUAR, SOFTUERIN DHE ÇDO PJESË PËRBËRËSE TË TIJ, SI DHE SIGURIMIN OSE MOSSIGURIMIN E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE. SMART NUK GARANTON QË FUNKSIONIMI I SOFTUERIT NUK PËRMBAN NDËRPRERJE APO DEFEKTE. SMART-i NUK I TESTON SOFTUERËT NË PRODUKTE TË KUFIZUARA OSE NË PRODUKTE TË TJERA QË NUK FURNIZOHEN NGA SMART-i. PËRDORUESI MERR PËRSIPËR GJITHË RREZIKUN SE SOFTUERI NUK DO TË FUNKSIONOJË PLOTËSISHT OSE SIÇ DUHET KUR PËRDORET ME PRODUKTE TË KUFIZUARA OSE PRODUKTE TË TJERA QË NUK FURNIZOHEN NGA SMART-i. KJO GARANCI E KUFIZUAR I JEP PËRDORUESIT TË DREJTA SPECIFIKE LIGJORE. PËRDORUESI MUND TË KETË TË DREJTA TË TJERA, TË CILAT MUND TË NDRYSHOJNË NGA JURIDIKSIONI NË JURIDIKSION.

10. **MOSPRANIMI I PËRGJEGJËSISË PËR DËMET ME PASOJA:** MOSPRANIMI I PËRGJEGJËSISË PËR DËMET ME PASOJA: DERI NË MAKSIMUMIN QË LEJOHET NGA LIGJI, SMART DHE FURNITORËT E TIJ NË ASNJË RAST NUK DO TË JENË PËRGJEGJËS PËR ASNJË DËM TË VEÇANTË, AKSIDENTAL, TË TËRTHORTË, TIPIK, ME PASOJA APO NDËSHKUES (DUKE PËRFSHIRË, POR PA U KUFIZUAR, DËMTIMET NDAJ PERSONIT APO PRONËS, DËMET PËR HUMBJE FITIMESH BIZNESI, NDËRPRERJE BIZNESI, HUMBJE INFORMACIONI BIZNESI, HUMBJE PRIVATËSIE, DËMET NË PROKURIMIN E MALLRAVE APO SHËRBIMEVE ZËVENDËSUESE, DËMET NGA HUMBJA TË PËRDORIMIT, TË DHËNAVE, DËME NGA MOSPËRMBUSHJA E DETYRIMEVE, DUKE PËRFSHIRË DETYRIMET E MIRËBESIMIT APO KUJDESIT TË ARSYESHËM, NGA NEGLIZHENCA OSE HUMBJE TË TJERA NË TË HOLLA) SI RRJEDHOJË E PËRDORIMIT OSE PAMUNDËSISË SË PËRDORIMIT TË PRODUKTIT TË LICENCUAR, OSE PRODUKTEVE TË TJERA SMART, SOFTUERIT APO CILËSDO PJESE PËRBËRËSE TË TIJ, OSE SIGURIMIT APO MOSSIGURIMIT TË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE, QOFSHIN TË BAZUARA NË KONTRATË, OSE SHKELJEVE CIVILE, NEGLIZHENCËS, PËRGJEGJËSISË SË CAKTUAR OSE TË TJERA, EDHE NËSE SMART-i APO CILIDO FURNITOR APO LICENCUES ËSHTË KËSHILLUAR PËR MUNDËSINË E KËTYRE DËMEVE. PËR SHKAK SE DISA JURIDIKSIONE NUK E

LEJOJNË PËRJASHTIMIN APO KUFIZIMIN E PËRGJEGJËSISË, KUFIZIMET E MËSIPËRME MUND TË MOS I APLIKOHEN PËRDORUESIT.

11. **KUFIZIMI I PËRGJEGJËSISË:** NË ÇDO RAST, PËRGJEGJËSIA E PLOTË E SMART-it DHE DËMSHPËRBLIMI I VETËM I PËRDORUESIT QË RRJEDH NGA KJO LICENCE NUK DO TË KALOJË SHUMËN DHJETË DOLLARË (CAD $10.00).

12. **FURNITORËT DHE LICENCUESIT E SMART-it:** FURNITORËT DHE LICENCUESIT E SMART-it: ÇDO PUBLIKIM, MOSPRANIM OSE KUFIZIM I PËRGJEGJËSISË SË SMART-it APO DËM SI PASOJË E KËSAJ LICENCE DO TË INTERPRETOHET, PËRVEÇSE NË DOBI TË SMART-it, EDHE NË DOBI TË FURNITORËVE, LICENCUESVE, PUNONJËSVE DHE KONTRAKTUESVE TË SMART-it, DHE PA U KUFIZUAR ME MJETET E TJERA MBROJTËSE QË KËTA FURNITORË, LICENCUES, PUNONJËS DHE KONTRAKTUES MUND TË KENË, PËRDORUESI BIE DAKORD T'I LIROJË KËTO PALË NGA PËRGJEGJËSIA APO DËMET SIPAS PUBLIKIMIT, MOSPRANIMIT OSE KUFIZIMIT TË PËRGJEGJËSISË APO DËMEVE PËR AQ SA KËTO PARASHIKIME I APLIKOHEN SMART-it.

13. **TË PËRGJITHSHME:**

13.1 **Konfidencialiteti.** Përdoruesi është në dijeni që softueri përmban informacion të fshehtë të SMART-it dhe/ose furnitorëve dhe licencuesve të tij. Për aq sa Përdoruesi ka mundësi ta përdorë këtë informacion, Përdoruesi bie dakord ta përdorë këtë informacion vetëm për përdorimin e autorizuar të Produkteve të Licencuara dhe Softuerit. Përdoruesi bie gjithashtu dakord të mos e zbulojë këtë informacion të fshehtë te një palë tjetër dhe ta mbrojë këtë informacion të fshehtë në të njëjtën shkallë që mbron informacionin e vet të fshehtë, por jo më pak sesa me një shkallë të arsyeshme kujdesi. Edhe Softueri i autorizuar me këtë Licencë do të konsiderohet informacion i fshehtë dhe, përveçse kur lejohet në mënyrë të veçantë në këtë Licencë, nuk do t'i zbulohet një pale të tretë.

13.2 **Zgjidhja me vendim gjykate.** Përdoruesi njeh se, në rast se Përdoruesi shkel një nga kushtet e kësaj Licence, SMART-i nuk do të ketë zgjidhje të përshtatshme në të holla apo dëmshpërblime. SMART-i do të ketë të drejtën të sigurojë një vendim gjykate kundër kësaj shkeljeje nga një gjykatë e juridiksionit kompetent menjëherë pas kërkesës, pa e shpallur detyrimin. E drejta e SMART-it për të përfituar zgjidhje me vendim gjykate nuk do të kufizojë të drejtën e tij për të kërkuar zgjidhje të mëtejshme.

13.3 **Ritransferimi.** Përdoruesi nuk mund ta ritransferojë këtë Licencë ose cilëndo nga të drejtat e Përdoruesit në këtë Licencë (nëpërmjet veprimeve ligjore apo të tjera) pa miratimin paraprak me shkrim nga SMART-i, i cili mund të mos jepet edhe pa arsye. Për qëllim të këtij paragrafi, caktimi apo transferimi do të përfshijë çdo ndryshim në shumicën e pronësisë ose kontrollit të Përdoruesit, duke përfshirë shkrirjen ose transferime të tjera të të drejtave të votës. SMART-i mund ta transferojë këtë Licencë pa miratimin e Përdoruesit. E kushtëzuar nga sa më sipër, kjo Licencë do të jetë e detyrueshme dhe do të hyjë në veprim në dobi të palëve të saj dhe përfaqësuesve përkatës ligjorë, pasuesve dhe personave të lejuar për ritransferim.

13.4 **Ndryshimi.** Asnjë ndryshim i kësaj Licence nuk do të jetë i detyrueshëm përveç rastit kur është me shkrim dhe është nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar i palës kundër të cilës kërkohet zbatimi i ndryshimit.

13.5 **Gjuha.** Çdo përkthim i kësaj Licence bëhet për kërkesa vendore dhe në rast konflikti mes versionit në anglisht dhe versioneve që nuk janë në anglisht, do të jetë mbizotërues versioni anglisht i kësaj Licence.

13.6 **Ligji drejtues.** Kjo Licencë drejtohet nga ligjet e Provincës së Albertës, Kanada. Gjithashtu, për aq sa lejon ligji në fuqi, palët bien dakord në mënyrë të parevokueshme që çdo çështje gjyqësore që përfshin këtë Licencë, Softuerin, një Produkt të Licencuar ose Produkt të Kufizuar, të sillet përpara gjykatave provinciale të Provincës së Albertës ose pranë gjykatave federale të

Kanadasë, sipas rastit. Përdoruesi bie dakord që nuk do të ngrejë pretendime për të mos zbatuar juridiksionin e këtyre gjykatave, se vendi i gjyqit është i papërshtatshëm, se gjyqi është i papërshtatshëm apo kundërshtime, pretendime apo argumente të ngjashme. Kjo Licencë nuk do të drejtohet nga Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Marrëveshjet për Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave, zbatimi i së cilës përjashtohet shprehimisht.

13.7 **Licenca e plotë.** Licenca përbën mirëkuptimin dhe Licencën e plotë të palëve dhe zëvendëson fuqinë e të gjitha përfaqësimeve, negociatave, dokumenteve të tenderave, propozimeve, mirëkuptimeve, dhe Licencave të mëparshme apo bashkëkohëse mes palëve në lidhje me lëndën subjekt të kësaj Licence. Nëse një dispozitë e kësaj Licence bëhet e pavlefshme, pjesa e mbetur e kësaj Licence do të vazhdojë të jetë plotësisht në fuqi dhe efektive.

13.8 **Heqja dorë.** Kur njëra palë nuk arrin të ushtrojë ndonjë prej të drejtave në këtë Licencë, kjo nuk do të thotë që se ajo heq dorë nga e drejta e kësaj pale për të ushtruar këtë të drejtë apo një të drejtë tjetër në të ardhmen.

13.9 **Forcat madhore.** Nuk do të gjykohet si shkelje e kësaj Licence pamundësia e cilësdo palë për të përmbushur detyrimet e saj nëse kjo mospërmbushje shkaktohet për shkak të zjarrit, fillimit të luftës, trazirave civile, akteve të terrorizmit, rregulloreve qeveritare, fatkeqësive natyrore, ose për shkaqe të tjera përtej kontrollit të arsyeshëm të palës që deklaron forcën madhore.

13.10 **Pyetjet.** Nëse Përdoruesi ka pyetje në lidhje me këtë Licencë, ose nëse Përdoruesi dëshiron të kontaktojë SMART-in për çfarëdo arsye, ju lutemi shkruani në adresën:

SMART Technologies ULC
3636 Research Road NW
CALGARY, AB CANADA T2L 1Y1

13.11 **Reagimet.** Nëse Përdoruesi i siguron SMART-it sugjerime, komente apo reagime (duke përfshirë modifikimet apo modifikimet e sugjeruara për ndonjë pjesë të Softuerit, Produktit të Licencuar, ose produkteve të tjera SMART) në lidhje me Softuerin, Produktin e Licencuar, ose produkte të tjera SMART, SMART-i do ta trajtojë atë si jo të fshehtë dhe do ta përdorë atë lirshëm për çdo lloj qëllimi, pa i dhënë kompensim, miratim apo ndonjë detyrim tjetër Përdoruesit.

13.12 **Njoftimet.** Përdoruesi mund t'i japë njoftim SMART-it duke e dërguar në adresën e mësipërme, ose adrese tjetër siç do t'ia ketë njoftuar SMART-i Përdoruesit së fundmi dhe do të dërgohet në vëmendje të "Attention: Legal Department". Njoftimi për Përdoruesin, duke përfshirë, pa u kufizuar me, përditësimet apo përmirësimet e Softuerit ose kësaj Licence, mund të sigurohet nga SMART-i a) duke ia dërguar Përdoruesit në adresën e emailit ose adresën e punës që ka të regjistruar, ose në adresën e emailit ose të punës që Përdoruesi mund t'i ketë njoftuar së fundmi SMART-it, ose b) duke i dhënë njoftim mbi programin e Përditësuesit të Produktit SMART, i aksesueshëm duke përzgjedhur "Kontrollo për përditësime" në dritaren e menysë "Ndihma".

13.13 **Publiciteti.** Gjatë shqyrtimit të licencës/licencave të dhënë(a) këtu, SMART-i mund të fusë Organizatën e Licencuar në listën e plotë ose të pjesshme të publikuar të klientëve të SMART-it.

13.14 **Vazhdimi i ekzistencës.** Detyrimet e përcaktuara në paragrafët 2.3 (b), (e), (f), (g), (h), dhe (l), 6, 7, 8, 10, 11, 12, 13.1, 13.2, 13.6, 13.11, 13.12, 13.13 dhe ky paragraf 13.14 do të vazhdojnë të ekzistojnë për çdo arsye pas përfundimit të kësaj Licence.

SMART dhe markat e lidhura të SMART janë marka tregtare të SMART Technologies ULC ose bashkëpunëtorëve të tij dhe mund të jenë të regjistruara në Shtetet e Bashkuara dhe juridiksione të tjera. Marka, logo dhe shenja të tjera janë marka tregtare të zotëruesve të tyre përkatës.

© 2010, SMART Technologies